



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), si dhe nenin 10, paragrafi 5, nenin 11, paragrafi 3, nenin 16, paragrafi 5, dhe nenin 22, paragrafi 7, të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018 miratoi këtë:

Rregullore për menaxhuesit e mjeteve pensionale

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së menaxhimit të mjeteve për Menaxhuesit e Mjeteve Pensionale të themeluar brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, si dhe përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxhuesve të Mjeteve, elementet themelore të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve dhe kërkesat themelore për investimin e mjeteve pensionale përmes Instrumentit për Investime të Hapura.
2. Kjo rregullore aplikohet për Menaxhuesit e Mjeteve Pensionale të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondeve Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit dhe Pensionet Plotësuese Individuale (më tej: Fondet Pensionale).

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet e përcaktuara si më poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1 *Marrëveshja për Menaxhimin e Mjeteve Pensionale* - nënkupton marrëveshjen mes Fondeve Pensionale dhe Menaxhuesit të Mjeteve Pensionale në lidhje me menaxhimin dhe investimin e fondeve pensionale.

- 1.2 *Menaxhimi i Mjeteve Pensionale* - nënkupton drejtimin, investimin, riinvestimin, strukturimin, ristrukturimin, përvetësimin, shitjen, transferimin ose bartje tjetër të mjeteve pensionale dhe këshillimin në lidhje me investimin e mjeteve pensionale.
- 1.3 *Parimet e Investimit* - nënkupton politikat e investimit dhe objektivat e performancës së investimeve të miratuara nga Fondet Pensionale për investimin e mjeteve pensionale, të shprehur në aktet normative të Fondit Pensional, rregullat e pensionit ose në direktivat e investimit.
- 1.4 *Direktiva e Investimit* - nënkupton urdhrat dhe udhëzimet e bëra nga Fondet Pensionale për menaxhuesit e mjeteve që specifikojnë kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve pensionale në pajtim me deklaratën e parimeve të investimit.
- 1.5 *Instrument për investime të hapura ("Open end Vehicles")* - nënkupton investimin përmes subjekteve të organizuara që veprojnë si kompani investuese dhe të cilët janë të autorizuar të emetojnë numër të pakufizuar të aksioneve të kapitalit (në njësi të pjesëshme apo të plota) duke paraqitur pronësi të barabartë proporcionale në subjektet e tilla nga aksionari, apo polisave të sigurimit ku pasuria kryesore grumbullohet për qëllime investuese. Ky term përfshin fondet reciproke, fondet investuese, fondet e njëjësive, polisat e sigurimit dhe mjetet tjera investuese, të cilët veprojnë në bazë të grumbullimit.
- 1.6 *Organet drejtuese* - nënkupton Bordin e Drejtues të Fondeve Pensionale

Neni 3

Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së Menaxhuesit të Mjeteve të themeluar në Kosovë

1. Menaxhuesi i Mjeteve i themeluar në Republikën e Kosovës duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e përcaktuara si në vijim:
 - 1.1 Të jetë i licencuar nga BQK-ja për ushtrimin e veprimtarisë së Menaxhuesit të Mjeteve në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale dhe Rregulloren për Licencimin e Menaxhuesve të Mjeteve për Mjetet e Fondeve Pensionale;
 - 1.2 Të ushtojë veprimtarinë e menaxhimit të mjeteve në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale, rregulloret e nxjerra për zbatimin e tij si dhe ligjet dhe rregulloret tjera në fuqi që ndikojnë në menaxhimin e mjeteve;
 - 1.3 Të marrë përgjegjësitë dhe detyrimet fiduciare ndaj Fondeve Pensionale si dhe ndaj pjesëmarrësve dhe përfituesve për menaxhimin e kujdesshëm të mjeteve të tyre pensionale. Këto përgjegjësi dhe detyrime fiduciare duhet të përfshihen në secilën marrëveshje për menaxhimin e mjeteve pensionale;
 - 1.4 Të mbajë, menaxhojë, regjistrojë, llogarisë dhe të bëjë raporte për mjetet të cilat janë nën menaxhimin e tij, veçmas për secilin Fond Pensional dhe ndaras nga të gjitha llogaritë e menaxhimit të mjeteve që ka me fonde ose persona tjerë;

1.5 Menaxhuesi i Mjeteve Pensionale do të mbikëqyret dhe rregullohet nga BQK-ja.

Neni 4

Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së Menaxhuesit të Mjeteve Pensionale të themeluar jashtë Kosovës

1. Menaxhuesi i Mjeteve i themeluar jashtë Republikës së Kosovës duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara si në vijim:
 - 1.1 Duhet të jetë i licencuar nga autoriteti mbikëqyrës dhe rregullator në ndonjërin prej shteteve të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OZHBE) dhe duhet të ofrojë dëshmi për këtë licencë, për BQK-në dhe Fondet Pensionale;
 - 1.2 Të ushtojë veprimtarinë e Menaxhuesit të Mjeteve në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në juridiksionin e vendit ku është licencuar dhe duhet të ofrojë dëshmi se është në gjendje të mirë financiare në juridiksionin përkatës;
 - 1.3 Të mbajë, menaxhojë, regjistrojë, llogarisë dhe bëjë raporte për mjetet të cilat janë nën menaxhimin e tij, veçmas për secilin fond pensional dhe ndaras nga të gjitha llogaritë e menaxhimit të mjeteve që ka me fonde ose persona të tjerë.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxhuesit të Mjeteve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxhuesit të Mjeteve janë:
 - 1.1 Të menaxhojë mjetet pensionale në pajtim me parimet e investimit dhe direktivat e investimit të lëshuara nga Fondet Pensionale, të cilat duhet të jenë në pajtim me këtë rregullore dhe Rregulloren mbi Investimet e Mjeteve Pensionale;
 - 1.2 Të kryejë investimin e mjeteve pensionale vetëm përmes Mbajtësit të autorizuar të mjeteve;
 - 1.3 Të mbajë shënime të përshtatshme për transaksionet e investimeve të mjeteve pensionale duke siguruar gjurmë/dëshmi për të gjitha transaksionet e investimeve;
 - 1.4 Të mbajë kopjet e dokumenteve të shlyerjeve që mbështesin ndonjë transfer, lëshim ose përvetësim të fondeve dhe letrave me vlerë që përbëjnë mjetet pensionale dhe të vërtetojë se këto dokumente korrespondojnë me udhëzimet themelore, kërkesat ose marrëveshjet me mbajtësin e mjeteve;
 - 1.5 Të ofrojë të gjitha informacionet e kërkuara nga Fondet Pensionale me të cilat ka marrëveshje për menaxhimin e mjeteve, siç është e nevojshme për këto fonde, për të qenë në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale, rregulloret në zbatim të tij si dhe ligjet e tjera të aplikueshme.

- 1.6 Të sigurojë se çdo marrëveshje, kërkesë ose udhëzim që e bën me Mbajtësin dhe/ose me Fondet Pensionale, për menaxhimin e mjeteve pensionale të jetë në pajtim me kushtet e deklaratës së parimeve të investimit dhe direktivave të investimit që përshtatet me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale dhe Rregulloren për Investimin e Mjeteve Pensionale;
- 1.7 Të sigurojë se ka themeluar një sistem adekuat dhe efektiv të kontrollave të brendshme për menaxhimin e mjeteve pensionale;
- 1.8 T'i raportojë menjëherë Fondeve Pensionale për çdo investim të mjeteve pensionale, nëse vlerëson se këto investime i shkelin kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale dhe rregulloreve në zbatim të tij dhe/ose ligjeve të tjera të aplikueshme.
- 1.9 Të përgatisë dhe dërgojë raporte të rregullta për Fondet Pensionale, të kërkuara sipas kushteve të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve. Raportet nga ky paragraf në të njëjtën kohë duhet t'i dërgohen edhe BQK-së;
- 1.10 Të raportojë menjëherë në BQK për çdo informacion që rrezikon ose mund të rrezikojë sigurinë e mjeteve pensionale apo që ekspozon ose mund të ekspozojë mjetet pensionale ndaj rrezikut të humbjes për shkak të veprimeve ose mosveprimeve (lëshimeve) të organeve më të larta drejtuese të Fondeve Pensionale dhe Mbajtësit të mjeteve, të cilat mund të çojnë në shkelje të Ligjit për Fondet Pensionale dhe rregulloreve në zbatim të tij ose të ndonjë detyrimi tjetër ligjor ose fiduciar;
- 1.11 Të raportojë menjëherë në BQK për çdo informacion për të cilin ka njohuri dhe i cili është ose mund të jetë mashtrim, pandershmëri ose keqpërdorim i mjeteve pensionale ose kur organet drejtuese të Fondeve Pensionale dështojnë ose vlerësohet se do të dështojnë në adresimin ose marrjen e masave përmirësuese për shkeljen e detyrave ligjore dhe fiduciare.

Neni 6

Marrëveshja për menaxhimin e mjeteve pensionale

1. Menaxhuesi i Mjeteve nuk mund të ushtrojë veprimtari të menaxhimit të mjeteve pa lidhur marrëveshje me Fondet Pensionale, për menaxhimin e mjeteve pensionale.
2. Çdo marrëveshje për menaxhimin e mjeteve pensionale duhet të jetë me shkrim, e nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar të Fondeve Pensionale dhe Menaxhuesit të Mjeteve. Marrëveshja duhet të përmbajë së paku elementet si vijon:
 - 2.1 Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Menaxhuesit të Mjeteve;
 - 2.2 Mënyrën se si Menaxhuesi i Mjeteve duhet t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë;
 - 2.3 Udhëzime specifike lidhur me të drejtat që rrjedhin nga investimi i mjeteve pensionale;
 - 2.4 Kompensimin apo tarifën për Menaxhuesin e Mjeteve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre;
 - 2.5 Kriteret dhe procedurat për shkëputjen e kontratës;

2.6 Sanksionet që mund të ndërmerren ndaj Menaxhuesit të Mjeteve në rastet e shkeljes së kushteve të marrëveshjes.

Neni 7

Investimet përmes Instrumentit për Investime të hapura nga Fondet Pensionale

1. Nëse organet drejtuese të Fondeve Pensionale, vendosin të investojnë disa ose të gjitha mjetet pensionale përmes Instrumentit për Investime të Hapura (“Open-End Vehicles”), duhet të zbatohen kërkesat si më poshtë:
 - 1.1 Instrumenti për Investime të Hapura duhet të jetë i themeluar dhe menaxhuar nga banka, kompani të sigurimeve ose institucione tjera financiare, të licencuara nga autoriteti i tregut financiar i një shteti anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), ku i kanë selitë, apo nga autoriteti i tregut financiar në Kosovë, për të ushtruar veprimtarinë e menaxhimit të mjeteve përmes Instrumentit për Investime të Hapura.
 - 1.2 Përcaktimi për të investuar përmes Instrumentit për Investime të Hapura, ndryshe nga disa forma tjera të menaxhimit të mjeteve, është përgjegjësi fiduciare e organeve drejtuese të Fondeve Pensionale, duke marrë parasysh kualitetin e investimit, shumën e mjeteve nën menaxhim, shpërndarjen e rrezikut të mjeteve të investuara dhe koston e menaxhimit.
 - 1.3 Instrumenti për Investime të Hapura pranon përgjegjësi fiduciare për Fondet Pensionale, pjesëmarrësit dhe përfituesit, për menaxhimin e matur të mjeteve pensionale.
 - 1.4 Organet drejtuese të Fondeve Pensionale duhet të përzgjedhin një Instrument për Investime të Hapura që harmonizon dhe aplikon politikat e investimeve në përputhje me deklaratën e parimeve të investimeve, të cilat duhet të jenë në pajtim me përcaktimet e nenit 9 të Ligjit për Fondet Pensionale.
 - 1.5 Organet drejtuese të Fondeve Pensionale në mënyrë periodike duhet të shqyrtojnë investimet e grumbulluara (pooled investment) të Instrumenteve për Investime të Hapura dhe të vlerësojnë pajtueshmërinë me parimet e investimeve të publikuara si dhe me nenin 9 të Ligjit për Fondet Pensionale. Organet drejtuese të Fondeve Pensionale do të raportojnë në BQK rezultatet e shqyrtimit të tillë së paku në çdo tre muaj. Shmangia nga parimet e investimeve nga ana e Instrumentit për Investime të Hapura, paraqet bazë për rishqyrtimin e përshtatshmërisë së investimit. Nëse shmangia e tillë vazhdon më shumë se gjashtë muaj, organet drejtuese të Fondeve Pensionale duhet të ndërmarrin hapa për tërheqjen nga Instrumenti për Investime të Hapura dhe të përzgjedhin një menaxhues të investimeve ose tjetër fond të grumbulluar (pooled fund) që i përmbush kërkesat e parimeve të investimeve.
 - 1.6 Instrumenti për Investime të Hapura duhet të mbajë kontabilitet të veçantë për mjetet pensionale të Fondit Pensional. Instrumenti për Investime të Hapura duhet të mbajë shënime dhe të raportojë mbi mjetet e përbashkëta (pooled assets) që janë nën menaxhimin e tij si dhe duhet të mbajë kontabilitet për pjesën që është në pronësi të Fondit Pensional, në totalin e mjeteve të grumbulluara (pooled assets).

- 1.7 Organet drejtuese të Fondit Pensional duhet të sigurojnë se Instrumenti për Investime të Hapura ka themeluar sistem të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit të brendshëm për mbajtjen dhe menaxhimin e fondeve të grumbulluara, dokumentimin e të gjitha blerjeve, shitjeve dhe transaksioneve relevante. Organet drejtues nuk kërkohet të përzgjedhin një Mbajtës të pavarur për këto mjete pensionale të Fondit Pensional që janë investuar në baza të grumbulluara (pooled basis) përmes blerjes së aksioneve të një Instrumenti për Investime të Hapura. Fondet Pensionale mund të mbështeten në Mbajtësin e Instrumentit për Investime të Hapura, duke u siguruar se Instrumenti për Investime të Hapura mban kontrolle të veçanta nga Menaxhuesi i Mjeteve.
- 1.8 Fondet Pensionale duhet të mbajnë të gjitha shënimet sa i përket investimeve përmes Instrumentit për Investime të Hapura.
- 1.9 Instrumenti për Investime të Hapura duhet t'i siguroj Fondet Pensionale se posedon licencë aktive sikurse kërkohet me nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të këtij neni.
- 1.10 Fondet Pensionale duhet të themelojnë procedura për të siguruar që të gjitha transferet e mjeteve nga Instrumenti për Investime të Hapura duhet të bëhen sipas vendimeve të përshtatshme ("proper") të organeve drejtuese të tyre si dhe për pagesat e pensionit ose shpenzimet.

Neni 8

Forma dhe përmbajtja e marrëveshjes me Fondet Pensionale

1. Instrumenti për Investime të Hapura nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e menaxhimit të mjeteve pensionale pa lidhur marrëveshje me shkrim me Fondet Pensionale të nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar të Fondeve Pensionale në njërën anë dhe zyrtarët e autorizuar të Instrumentit për Investime të Hapura në anën tjetër.
2. Marrëveshja sipas paragrafit 1 i këtij neni duhet të përmbajë së paku elementet si në vijim:
 - 2.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e Instrumentit për Investime të Hapura, kushtet për blerjen e aksioneve dhe klasat e mjeteve të përdorura si dhe ndonjë kufizim lidhur me to.
 - 2.2 Procedurat për mbajtjen e mjeteve dhe identitetin e Mbajtësit të mjeteve të Instrumentit për Investime të Hapura.
 - 2.3 Kompensimin dhe/apo tarifën për Instrumentin e Investimeve të Hapura dhe mënyrën e llogaritjes së tyre.
 - 2.4 Kriteret dhe procedurat për shkëputjen e kontratës.
 - 2.5 Sanksionet që mund të ndërmerren ndaj Instrumentit për Investime të Hapura, në rastet e shkeljes së kushteve të marrëveshjes.

Neni 9
Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 10 për Ndryshimin e Rregullës për Menaxherët e Pronave të Mjeteve të Pensioneve, e datës 4 prill 2007.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore